



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1563, datë 20.04.2011**

**Për**

**“Për miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave të Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave të Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme ;

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 5, neni 99 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr.9902, datë 17.04.2008 “ Për mbrojtjen e konsumatorëve”(Ligj nr.9902);
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

## **K Ë SHILLI D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- relacion shpjegues (*relacioni*);
- projektvendim i KD(*projektakti*);
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar

## **V Ë R E N:**

1. Eagle Mobile sh.a ka depozituar në AKEP me shkresën nr.760 prot, datë 28.02.2011 kërkesën “Për miratimin e Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) së Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme
2. Eagle Mobile sh.a ka kërkuar modifikimin pjesërisht të Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të miratuar me VKD nr. 1267, datë 28.04.2010 duke atakuar gjithsej 9 kapituj.
3. Eagle Mobile sh.a ka bashkëngjitur në formë të shkruar Kontratën e Pajtimit Tip të modifikuar.
4. Eagle Mobile sh.a ka kërkuar nga AKEP reduktime, shtesa dhe riformulime në pjesë të ndryshme të Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) duke filluar tek pjesa e Hyrjes së Termave të Përgjithshme, Përkufizimet, dhe duke vazhduar me kapitujt nr. 3, nr. 5, nr. 6, nr. 10, nr. 11, nr. 13, nr. 14, nr. 16, nr. 20, nr. 23 dhe nr. 24.
5. Në bazë të shqyrtimit të Kontratës Tip AKEP konstaton se disa prej ndryshimeve dhe shtesave të propozuara nga Eagle Mobile sh.a janë korrekte dhe qëndrojnë, kryesisht te pjesa e Hyrjes, Përkufizimet, dhe kapitujt 3, 5, 10, 11, 13, 14, 16, 20, dhe 24.
6. AKEP, me qëllimin e mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, bazuar në:
  - a. Qëllimin e garantimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në Shqipëri, të shprehur në nenin 1 të ligjit nr. 9918, dhe
  - b. Objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në germet ‘a’ dhe ‘b’, pika 3, neni 7 i ligjit nr. 9918.ka konsideruar dhe vlerësuar modifikimet e propozuara nga sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a si të arsyeshme në termat e përgjithshme të kontratës ;
7. Ndryshimet e kërkuara në termat e përgjithshëm nga Eagle Mobile sh.a kanë marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të legjislacionit në fuqi në Shqipëri,

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij dokumenti për sipërmarrësin dhe për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, bazuar në pikën 1 të

nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

### **V E N D O S :**

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e Eagle Mobile sh.a. duke miratuar disa ndryshime dhe shtesa në Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontrata Tip) të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a., me Pajtimtarin për Shërbimin Publik Telefonik të Lëvizshëm, duke i ndryshuar ato sipas dokumentit bashkengjitur (Aneksi1, “Ndryshime dhe shtesa të Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”
2. Eagle Mobile sh.a të depozitojë një kopje te kontrates Tip në AKEP dhe ta publikojë në faqen e tij të Internetit brenda datës 30.05.2011.
3. Ky Vendim t’i njoftohet sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a brenda 8 ditëve nga data e nxjerrjes së tij.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

## **EAGLE MOBILE**

### **Aneksi 1**

#### **Ndryshime dhe shtesa të Termave të Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Eagle Mobile sh.a me pajtimtarin për shërbimin e telefonisë publike të lëvizshme”**

### **HYRJE**

#### **Ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“ Këto kushte të përgjithshme (Kushtet e përgjithshme) së bashku me formularin e pajtimit për në rrjetin Eagle Mobile dhe tarifatat e shërbimeve sipas programit tarifor të zgjedhur nga pajtimtari, dhe të nënshkruara prej të dy palëve, përbëjnë “Kontratën” midis Eagle Mobile (më poshtë referuar EM) dhe kërkuesit qoftë ky person fizik apo përfaqësues i autorizuar i personit juridik (më poshtë “Pajtimtari”)

### **1. PERKUFIZIME**

a) Shtohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

EAGLE MOBILE SH.A, (EM) është shoqëria anonime me të njëjtin emër, e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me numër 30436, datë 24.10.2003, NIPT-i K41406043S, me adresë Rruga "Murat Toptani", Qendra e Biznesit 12 katëshe, kati 9-10, Tiranë, e cila ushtron aktivitetet në fushën e komunikimeve elektronike dhe është njoftuar rregullisht në bazë të regjimit të autorizimit të përgjithshëm dhe është regjistruar në Regjistrin e Sipërmarrësve të botuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

b) Hiqet paragrafi i dytë i përkufizimit b) dhe mbetet i pandryshuar paragrafi I me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Pajtimtar, është individi, person fizik ose juridik, të dhënat e të cilit gjenden në formularin për pajtim dhe të cilit i jepet e drejta të përdorë shërbimet e sistemit të telefonisë së lëvizshme të EAGLE MOBILE”.

d) Ndahet në dy përkufizime si më poshtë vijon:

“**Pajtimtar me parapagim** (Përdorues fundor me parapagim) pajtimtari i cili ka zgjedhur mënyrën me parapagim të pagesës për shërbimet që do përfitojë”

**‘‘Pajisja fundore e pajtimtarit** është çdo lloj pajisje e miratuar nga autoritetet përkatëse kompetente dhe që është në përputhje me karakteristikat e rrjetit EAGLE MOBILE, nëpërmjet së cilës kryhet komunikimi nga pika në pikë’’

**Shtohet tek përkufizimi ‘‘Pajtimtar me parapagim’’ si më poshtë vijon :**

‘‘Eagle Mobile do të zbatojë dispozitat e ‘‘Kushteve të përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për pajtimtarin’’, për pajtimtarin me parapagim, për aq sa ato janë të zbatueshme për këtë kategori pajtimtarësh, duke i përfshirë këto në paketat e shitjes me parapagesë.’’

**Shtohet përkufizimi pika i, Kapitulli 1, me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

**‘‘ i) Bartja e numrit është procesi i transferimit të numrit të një pajtimtari nga rrjeti i Eagle Mobile tek një operator tjetër dhe anasjelltas. ‘‘**

**Pika s), Kapitulli 1, ndryshohet si më poshtë vijon:**

**‘‘Plani tarifor është mundësia që i jepet çdo pajtimtari të zgjedhë shërbimet e sistemit sipas nevojave të tij, siç përcaktohet në formularin për pajtim.’’**

### **3. LIDHJA ME SISTEMIN/ DHENIA E SHËRBIMEVE**

**Shtohet në fund të Kapitullit 3, me përmbajtjen si më poshtë vijon :**

**‘‘...në përputhje me kuadrin rregullator përkatës për Portabilitetin e Numrit.’’**

#### **1. MENYRA E PAGESES**

**Në Kapitullin 5., pika a)**

**Shtohen pjesët e fjalisë si më poshtë vijon:**

**‘‘ose në mënyrë elektronike apo SMS, nëse pajtimtari ka dhënë pëlqimin për këtë mënyrë faturimi ; ‘‘dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë kalendarike përpara afatit të pagesës së saj’’.’’**

### **10. PERDORIMI I SHËRBIMEVE ME VLERE TE SHTUAR DHE LOJERAT PROMOCIONALE**

**Ndryshohet në Kapitullin 10/Pika 10.1, fjala ‘‘licensuar’’, zëvendësohet me ‘‘autorizuar’’**

**Ndryshohet në Kapitullin 10 / Pika 10.4 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

**‘‘Të miturit ndalohet të përdorin Shërbimet me Vlerë të Shtuar që u drejtohen vetëm personave madhorë mbi 18 vjeç dhe Shërbime me Vlerë të Shtuar, përfshirë pjesmarrje në lojra, që kushtojnë të paktën 120 lek/minutë (me TVSH). Me qëllim mbrojtjen e të miturve, ofrimi i shërbimeve të tilla nga Eagle Mobile dhe/ose ofrues të tjerë të këtyre shërbimeve të cilët kanë marrveshje me Eagle Mobile, do të kryhet, sipas rregullave për ofrimin e këtyre shërbimeve.’’**

Eagle Mobile do të marrë masa të tilla si paralajmërimi për moshën e lejuar të përdorimit të këtyre shërbimeve dhe informacion për rregullat e lojës dhe çmimin e tyre”

## **11. DETYRIMET E EAGLE MOBILE**

### **Hiqet pika 11.2.5 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“**11.2.5** Të njoftojë me shkrim pajtimtarin për rastet e hedhjes në treg të paketave tarifore që kanë terma dhe kushte (përfshirë tarifa) qartësisht më të mira për pajtimtarin se paketa e zgjedhur prej tij, duke i dhënë mundësinë e ndryshimit të paketës tarifore.”

### **Ndryshohet përmbajtja e pikës 11.2.7 si më poshtë vijon:**

“Të aplikojë rritjen e tarifës së një apo më shumë shërbimeve të zgjedhura nga pajtimtari në kontratë, vetëm pas ezaurimit të procesit të njoftimit të pajtimtarit nga Eagle Mobile të paktën 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre, sipas përcaktimeve në nenin 20.”

### **Hiqet pika 11.2.10 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“**11.2.10** Të mos pezullojë apo ndërpresë shërbimin ose kontratën nëse pajtimtari ka shkelur kushtet e një kontrate tjetër me Eagle Mobile.”

### **Në Kapitullin 16/Pika c), nënparagrafi II, plotësohet fjalia me pjesën si më poshtë vijon :**

“në përputhje me Rregulloren nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”.

## **20. NDRYSHIMI I KUSHTEVE TE KONTRATES**

### **Ndryshohet pika d) e Kapitullit 20 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“Për çdo modifikim/zëvendësim të kushteve të përgjithshme, reduktimi të shërbimeve/cilësisë dhe rritje të tarifave të shërbimeve të zgjedhura nga pajtimtari, Eagle Mobile duhet :

- i Të njoftojë Pajtimtarin me kontratë nëpërmjet njoftimit individual (mund të jetë edhe me SMS apo me telefon nëpërmjet Call Center-Shërbimi i klientit) të paktën 30 (tridhjet) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. Njoftimi individual duhet të përfshijë adresën se ku janë publikuar ndryshimet/termat e reja, në rast se njoftimi nuk përmban detaje të mjaftueshme të ndryshimeve;
- ii Të njoftojë Pajtimtarët me parapagim, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre dhe ky njoftim duhet të bëhet për jo më pak se 3 (tre) dite rrjesht ose nëpërmjet SMS/telefonatë si në pikën ‘i’ më sipër.”

### **Shtohet pika g) Kapitulli 20 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

- g) “ Ndryshimet e cituara në pikën 20/d, hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar nga AKEP (në rast se ato janë objekt miratimi nga AKEP) ose nga Eagle Mobile.”

### **Kapitulli 20 / Pika e) ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“Në rast se pajtimtari nuk njofton me shkrim Eagle Mobile, sipas pikës 20/g, pajtimtari konsiderohet se i pranon në heshtje ndryshimet dhe efektet e ndryshimeve zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të tyre pa qënë i detyrueshëm nënshkrimi i tyre (të një amendamenti apo kontratës

së re) nga të dy palët . Palët kanë të drejtë të nëshkruajnë amendamentet apo kontratën e re, në çdo kohë para apo pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve.”

**Kapitulli 20 / Pika f) ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“Në rast se pajtimtari nuk është dakord me modifikimin e kushteve të kontrates (përfshirë rritjen e tarifave) të cituar në pikën 20/d, pajtimtari ka të drejtë të mos pranojë modifikimin/zëvendësimin e kontratës dhe ta anulojë kontratën duke njoftuar Eagle Mobile me shkrim, ose në zyrat e tij, para afatit të hyrjes në fuqi të tyre. Zgjidhja e kontratës nuk do të heqë detyrimet që pajtimtari ka në bazë të kontratës së vjetër.”

**Shtohet pika h) Kapitulli 20 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“h) Përmirësimi i shërbimeve për pajtimtarin si ulja e tarifave dhe rritja e cilësisë/shërbimeve mund të aplikohen nga Eagle Mobile pa qenë nevoja e njoftimit.”

## **24. VLEFSHMERIA/AFATI**

**Kapitulli 24 / Pika 24.1.1 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“Kjo kontratë lidhet për një afat të përcaktuar prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës prej pajtimtarit.”

**Ndryshohet si më poshtë vijon Kapitulli 24 / Pika 24.1.2:**

- “Nëse pajtimtari nuk ka njoftuar Eagle Mobile, me shkrim, ose në zyrat e saj, se nuk dëshiron vazhdimin e kontratës përtej afatit 12 (dymbëdhjetë) mujor, kontrata kthehet në kontratë me afat të pacaktuar.
- Secila palë ka të drejtë të kërkojë prishjen e njëanshme të kontratës, sipas përcaktimeve të dhëna në këtë kontratë.”

Në këtë kapitull **ndryshohet** : afati **2 (dy)** mujor në afat **12 (dymbëdhjetë)** mujor.

**Hiqet pika 24.1.2 me përmbajtjen si më poshtë vijon:**

“30 (tridhjet) dite kalendrike para mbarimit të këtij afati, Eagle Mobile njofton me shkrim pajtimtarin, duke e informuar atë për:

- mbarimin e afatit maksimal të kontrates;
- të drejtën e zgjidhjes së kontrates nga pajtimtari pa detyrime shtese për perfundimin e kontrates brenda këtij afati;
- të drejtën e rilidhjes së një kontrate të re.”





